



Udhëzimi 5

Shtator 2016

Prokurimi publik

Të kuptuarit e kufijve monetarë të BE-së

PËRMBAJTJA

- [Kufijtë ekzistues](#)
- [Kur përcaktohen kufijtë monetarë?](#)
- [Cilat parime zbatohen në llogaritjen e kufijve monetarë?](#)
- [A zbatohen rregulla të tjera për llogaritjen e vlerës së kontratave?](#)
- [Kontratat poshtë kufijve monetarë të BE-së](#)
- [Shërbimet](#)
- [Informacion i mëtejshëm](#)

Autorizuar për botim nga Karen Hill, Drejtuese e Programit të SIGMA-s.

Kufijtë ekzistues

Direktiva e Sektorit Publik (Direktiva)¹ zbatohet vetëm për kontratat e një lloji të caktuar dhe me një vlerë që e plotëson ose tejkalon kufirin përkatës monetar të BE-së.

Kufijtë e përgjithshëm

Kufijtë monetarë ndryshojë në mënyrë të rregullt, zakonisht çdo dy vjet. Për periudhën nga 1 janari 2016 deri më 31 dhjetor 2017, Kufijtë e përgjithshëm monetarë për autoritetet kontraktore janë si më poshtë:

- 5 225 000 Euro për punët
- 209 000 Euro ose 135 000 Euro për furnizimet dhe shërbimet
- 750 000 Euro për shërbimet e regjimit të lehtë
- 5 225 000 Euro për koncesionet

Kufijtë e tanishëm monetarë mund të verifikohen në faqen e internetit të Komisionit Evropian: www.simap.europa.eu

Këta kufij monetarë pasqyrojnë nivelin në të cilin BE-ja vlerëson se është e mundshme tregtia ndër-kufitare. Është e mundur që, në varësi të rrethanave, operatorët ekonomikë mund të jenë të interesuar në kontratat poshtë kufirit monetar në Shtetet e tjera Anëtare të BE-së. Kufijtë monetarë janë vendosur edhe për të siguruar që kostot administrative të zbatimit të një procedure të plotë të tenderit të BE-së justifikohen si proporcionale me vlerën e kontratës që shpallet.

Ka një numër kufijsh monetarë; zbatohen kufij të ndryshëm monetarë për llojet e ndryshme të autoriteteve kontraktore dhe për lloje të ndryshme të kontratave. Prandaj, autoritetet kontraktore duhet ta dinë se çfarë lloj autoriteti kontraktor janë dhe çfarë po blejnë në mënyrë që të përcaktohet kufiri monetar i saktë.

Disa dispozita mjaft komplekse rregullojnë llogaritjen e vlerës së kontratave. Përveç kësaj, dispozita specifike mbulojnë llogaritjen e vlerës së marrëveshjeve kuadër, sistemet dinamike të blerjes, konkurset e projektimit, dhe kontrata e koncesionit të punëve.

Kur përcaktohen kufijtë monetarë?

Kufijtë monetar janë në përgjithësi të fiksuar për një periudhë prej dy vjetësh dhe ndryshojnë çdo dy vjet, duke hyrë në fuqi nga 1 janari. Ndryshimet bëhen me anë të rregulloreve të Komisionit Evropian. Dispozitat mundësojnë ndryshimin e kufijve monetarë në raste të tjera. Kufijtë e tanishëm monetar mund të gjenden në faqen e internetit të Komisionit Evropian: www.simap.europa.eu

Kufijtë e përgjithshëm për kontratat e punëve, të furnizimeve dhe të shërbimeve: Këto kufij të përgjithshëm nuk janë vetëm kufijtë e vetëm, por ata janë ata kufij që përmenden më shpesh në praktikë, pasi ata zbatohen për shumicën e llojeve të kontratave të shpallura nga autoritetet kontraktore.

Kufijtë janë të ndryshëm për 1) kontratat e punëve, 2) kontratat e furnizimeve dhe të shërbimeve, dhe 3) kontratat e shërbimeve të regjimit të lehtë. Kufiri monetar për kontratat e punëve është shumë më i lartë se kufijtë monetarë të kontratave të furnizimeve, shërbimeve dhe të shërbimit të regjimit të lehtë.

Ka dy kufij të ndryshme për kontratat e furnizimeve dhe shërbimeve. Kufiri monetar më i ulët vlen për shumicën e blerjeve nga organet publike, në varësi të Marrëveshjes së Prokurimit Qeveritar të

¹ Direktiva 2014/24/BE për prokurimet publike dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/18/KE, 26 shkurt 2014.

Organizatës Botërore të Tregtisë (GPA), dhe kufiri monetar më i lartë vlen për autoritetet e tjera kontraktore që nuk janë subjekt i GPA-së.

Kufij të tjerë: Ka kufij të tjerë specifik për lote të vegjël, për kontratat e subvencionuara të punëve dhe kontratat e subvencionuara të shërbimeve, për kontratat në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes që janë subjekt i Direktivës së Mbrojtjes², dhe kontratat e koncesionit që janë subjekt i Direktivës së Koncesioneve.³

Cilat parime zbatohen në llogaritjen e kufijve monetarë?

Për llogaritjen e vlerës së parashikuar të të gjitha llojeve të kontratave zbatohen një numër parimesh të përgjithshme:

- Llogaritja bazohet në shumën e pagueshme në total ose në vlerën totale të kontratës, dhe në rastin e kuadrit dhe sistemeve dinamike të blerjeve dhe të kontratave të ndara në lote, shuma është vlera në total e të gjitha kontratave të mundshme që do të jepen në bazë të marrëveshjes .
- Të gjitha elementet monetare dhe jo-monetare që mund të paguhen llogariten, duke përfshirë edhe pagesat nga burime të palës së tretë.
- Vlera e llogaritur e kontratës duhet të marrë parasysh shumën e vlerësuar në total, duke përfshirë të gjitha opsionet dhe rinovimet (edhe në qoftë se këto opsione ose rinovime nuk ushtrohen në vijim), si dhe të gjitha shpërblimet dhe pagesat e tjera të bëra për të gjithë kandidatët ose ofertuesit.
- Llogaritja përjashton taksën e vlerës së shtuar.
- Nuk duhet të ketë nën-ndarje të kontratave që synojnë të shmangin qëllimisht zbatimin e Direktivës.
- Llogaritja duhet të jetë e vlefshme në momentin kur njoftimi i kontratës për kontratën specifike dërgohet në Zyrën e Gazetës Zyrtare të Bashkimit Evropian (GZBE), ose kur ky njoftim nuk është i nevojshëm, në momentin kur autoriteti kontraktor fillon procedurat për dhënien e kontratës.

A zbatohen rregulla të tjera për llogaritjen e vlerës së kontratave?

Përveç këtyre parimeve të përgjithshme, zbatohen edhe rregulla të rëndësishme të detajuara për llogaritjen e vlerës së çdo lloj kontrate dhe për llogaritjen e vlerës së një kontrate në rrethana të veçanta. Autoritetet kontraktore duhet t'i shqyrtojnë me kujdes këto rregulla kur llogaritet vlera e kontratave.

Qëllimet kryesore të parimeve të përgjithshme dhe dispozitave të veçanta që kanë të bëjnë me llogaritjen e vlerës së kontratave janë për të siguruar se: 1) ka një para-llogaritje të vërtetë dhe transparente të vlerës së kontratës që do të jepet, dhe; 2) autoriteti kontraktor nuk do të përpiqet që të shmangë zbatimin e Direktivës, për shembull, duke ndarë një kërkesë ose një kontratë në paketa apo kontrata të vogla që janë poshtë kufirit monetar.

Këto rregulla mbulojnë atë se si trajtohen kërkesat e ngjashme ose të përsëritura dhe se si të trajtohen kontratat ku afati apo vlera mund të jetë e pasigurta, dhe rregullat përfshijnë heqjen dorë për kontrata të vogla në kuadër të loteve. Rregullat gjithashtu përfshijnë dispozita që mbulojnë situatën kur autoriteti kontraktor jep një numër kontratash për një projekt të caktuar ose një numër kontratash për furnizime ose shërbime të ngjashme. Termi që përdoret shpesh për t'iu referuar

² Direktiva 2009/81/KE mbi koordinimin e procedurave për dhënien e kontratave të caktuara të punëve, të kontratave të furnizimeve dhe të kontratave të shërbimeve nga autoritetet apo subjektet kontraktore në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë dhe ndryshimin e Direktivave 2004/17/KE dhe 2004/18/KE, 13 Korrik 2009.

³ Direktiva 2014/23/BE për dhënien e kontratave të koncesionit, 26 shkurt 2014.

kërkesave të përfshira, kur merret parasysh një numër kontratash ose një numër kërkesash të përsëritura ose të ngjashme është "agregimi".

Kontratat poshtë kufijve monetarë të BE-së

Dispozitat e agregimit: Kërkesat për të llogaritur nëse një kontratë ka një vlerë që tregon se ajo duhet të shpallet apo jo duke përdorur njoftimin e kontratës të publikuar në GZBE janë të rëndësishme për të gjitha kontratat, madje edhe ato që mund të duken se janë nën kufijtë monetarë të BE-së, për të përcaktuar nëse zbatohet apo jo Direktiva.

Dispozitat e agregimit nënkuptojnë se, për shembull, një numër kontratash të ngjashme, secila prej të cilave është nën kufiri monetar të BE-së, ende mund të jenë subjekt i Direktivës. Arsyeja për këto dispozita është se vlera në total e të gjitha kontratave duhet të mbledhet së bashku nëse plotësohen disa kushte, dhe atëherë vlera në total mund të kalojë kufiri monetar i BE-së. Direktiva do të zbatohet për të gjitha kontratat.

Rregulli që zbatohet për kontratat që janë poshtë kufirit monetar: Statistikat tregojnë se shumica e kontratave që janë dhënë nga autoritetet kontraktore nuk janë subjekt i kërkesës për t'u shpallur në GZBE. Për shembull, kontrata mund të jetë e një lloji që nuk është subjekt i këtyre detyrimeve ose ajo mund të jetë me vlerë të ulët dhe, për këtë arsye, nuk i plotëson kufijtë monetarë të BE-së.

Shtetet Anëtare të BE-së kanë zgjedhur përgjithësisht për të futur rregullat e tyre për kontratat poshtë kufirit monetar dhe për kontratat tjera që nuk janë subjekt i kërkesave të detajuara të prokurimit të Direktivës. Autoritetet individuale kontraktore mund të lejohen ose mund t'u kërkohej gjithashtu që të publikojnë dhe të ndjekin rregullat e tyre të brendshme të blerjes, të cilat mund të përfshijnë futjen e kufijve të tjerë kombëtare dhe/ose lokal monetar.

Kufijtë monetar kombëtar dhe/ose lokal mund të nxisin lloje të ndryshme kërkesash për sa i përket reklamave dhe proceseve të tenderit. Këto kërkesa ndihmojnë për të siguruar transparencë dhe trajtim të barabartë. Për shembull:

- Ftesat direkte, të cilat mund të lejohen për kontratave me vlerë shumë të ulët;
- Procedurat e thjeshtëzuara, të tilla si kuotat konkurruese apo ftesat për oferta nga një numër i caktuar operatorësh ekonomik, ose shpallja lokale dhe një proces konkurrues lokal për kontratat me vlerë të mesme që janë nën nivelet e kufiri monetar të BE-së.

Shërbimet

Kufijtë për kontratat e furnizimeve dhe shërbimeve dhe për kontratat e shërbimeve të regjimit të lehtë janë më të larta se ato që zbatohen për sektorin klasik. Megjithatë, ashtu si në rastin e sektorin klasik, kufijtë që zbatohen për shërbimet vendosen në përgjithësi çdo dy vjet, dhe kufijtë ekzistues mund të gjenden në faqen e internetit të Komisionit Evropian: www.simap.europa.eu.

Shumica e parimeve të përgjithshme të përshkruara më lart zbatohen në mënyrë të barabartë për shërbimet, por koha e llogaritjes së vlerës është e ndryshme. Afati për llogaritjen e vlerës varet nga mënyra në të cilën është nisur procedura. Afati përkatës është si më poshtë:

- Sistemi i kualifikimit: data në të cilën fillon përzgjedhja;
- Njoftim Periodik Orientues: data e dërgimit të njoftimit të kontratës në *GZBE*;
- Rastet e tjera: data në të cilën njoftimi i kontratës do të dërgohet në *GZBE* nëse zbatohet ftesa për konkurrim dhe subjekti kontraktor ka vendosur që të përmbushë ftesën për konkurrim me anë të një njoftimi të tillë të kontratës.

Dispozita të detajuara të Direktivës së Shërbimeve⁴ mbulojnë mënyrën sipas së cilës llogaritet vlera e kontratës për lloje të veçanta të kontratave dhe situata të veçanta, dhe disa nga këto dispozita ndryshojnë nga rregullat që zbatohen në sektorin klasik. Megjithatë, ashtu si në sektorin klasik, qëllimet kryesore të dispozitave që lidhen me llogaritjen e vlerës së kontratave janë për të siguruar që: 1) ka një para-llogaritje të vërtetë dhe transparente të vlerës së kontratës që do të jepet, dhe; 2) autoriteti kontraktor nuk do të përpiqet që të shmangë zbatimin e Direktivës, për shembull, duke ndarë një kërkesë ose një kontratë në paketa apo kontrata të vogla që janë poshtë kufiri monetar.

⁴ Direktiva 2014/25/BE për prokurimet nga subjektet në sektorin e ujit, energjisë, transportit dhe sektorëve të shërbimeve postare dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/17/KE, 26 shkurt 2014.

Informacion i mëtejshëm

Manuali i Trajnimit për Prokurimin Publik– Moduli D5

<http://www.sigmaweb.org/publications/public-procurement-training-manual.htm>